

## Identitetet e hershme “kelte” në Italinë Veriore dhe Adriatikun e Epërm

Linda Papi

AOROC – CNRS – ENS

École Normale Supérieure, Paris

[linda.papi@ens.psl.edu](mailto:linda.papi@ens.psl.edu)

### Abstrakti

Ky studim ka për qëllim të hulumtojnë praninë kelte në Italinë Veriore dhe në Adriatikun e Epërm gjatë fazës para pushtimit historik të vitit 388 para Krishtit. Sipas burimeve klasike, në fillim të shekullit IV para Krishtit, komunitetet kelte kaluan Alpet dhe u vendosën në Itali. Për shkrimitarët e lashtë, ky depërtim konsiderohej një ngjarje brutale, por dëshmitë arkeologjike tregonjë një situatë ndryshe, duke sugjeruar se prania kelte në Itali mund të gjurmohet që në shekujt e mëparshëm. Në shekullin V para Krishtit, Italia Veriore ishte e organizuar në njësi të mëdha kulturore që tregonin marrëdhënie të ngushta me komunitetet në veri të Alpeve, të bazuara në një sistem shkëmbimi në distanca të gjata. Në këtë kontekst të larmishëm, vërejmë përhapjen progresive të elementeve të fazës së vonë Halshtatit dhe Latenit. Do të fokusohemi në shembullin e vathëve të venetëve adriatikas, të gjetur në të dyja anët e Detit Adriatik. Artefaktet prej metali janë një fushë optimale për të reflektuar mbi këtë lloj hetimi. Prania e tyre na tregon përmasat e lëvizshmërisë individuale dhe na mundëson të thellojmë njojuritë mbi strategjitet e transferimit kulturor, transmetimin e modeleve dhe qarkullimin e njerëzve dhe mallrave.

Fjalë kyçë: *Epoka e Hekurit, lëvizshmëria individuale, imigrimi kelt, Hallstatt, La Tène.*

### Hyrje

Sipas traditës historiografike, vitet 390-386 para Krishtit, u karakterizuan nga një migrim masiv i keltëve, kur një grup Senonësh kaloi Alpet në Itali, pushtoi Luginën e Pos dhe i shkaktoi Romës njérën nga disfatat më të hidhura në historinë e saj (DS., XIV, 113-117; Plut., Cam., 15, 32; Pol., II, 18, 2; Liv., V, 35-55). Tekstet klasike e përshkruajnë këtë depërtim si një ngjarje brutale. Ato ofrojnë një pamje të gjallë – dhe përfshijnë anekdota të përshkuara herë pas here me ironi – mbi Këltot, Galatot, galli, të cilët kaluan Alpet në numër të madh, duke tronditur gadishullin. Këto rrëfime janë

të lidhura ngushtë me historinë romake (Lejars 2005, 30-31). Ato ndikohen nga një sërë faktorësh, duke përfshirë kontekstin historik, propagandën politike të kohës dhe një hendek kronologjik prej disa shekujsh midis ngjarjeve të përshkruara. Ndonjëherë, miti ndërthuret me historinë. Për shembull, ekziston rrëfimi i qytetarit gal Helico nga Plini Plak: duke praktikuar *ars fabrilis* në Romë, ai solli fiq të thatë, rrush, mostra të vajit dhe verës në atdheun e tij përtej Alpeve. Dëshira për këto produkte u dha Galëve justifikimin e nevojshëm për të shpallur luftë (Plini Plaku., Nat. Hist. XII, 5).<sup>1</sup>

Koha e pushtimeve paraqet gjithashtu një problem, pasi bazohet në sinkronizimin e ngjarjeve specifike historike (Bourdin 2012, 594-595 me referenca burimore).<sup>2</sup> Burimet arkeologjike tregojnë një situatë të ndryshme: gjurmët e para të një pranie kelte në Italinë Veriore shfaqen në fund të shekullit VII p.e.s. dhe shtohen me kalimin e kohës. Në fillim të Epokës së Hekurit, Italia ishte e organizuar në njësi të mëdha kulturore që kishin marrëdhënie të privilegjuara me shoqëritë në veri të Alpeve, përmes një rrjeti shkëmbimi në distanca të gjata (Frey 1987, 11-12). Burimet epigrafike konfirmojnë se kontakte të tilla ndodhën që në një fazë të hershme - në fillim të shekullit VI para Krishtit - siç dëshmohet nga cipusi II i Rubierës dhe mbishkrimi i Castelletto Ticino-së (De Marinis 1991, 96; Verger, 2015, 78).

### **Keltët para keltëve?**

Identiteti i galëve dhe migrimi i tyre në Itali ka qenë objekt studimi për më shumë se një shekull, falë bollëkut të provave arkeologjike, burimeve epigrafike dhe atyre të shkruara. Edhe pse autorët klasikë janë relativisht të njëzëshëm në datimin e valës së madhe të imigrimit në fillim të shekullit IV para Krishtit, të dhënët arkeologjike zbulojnë një realitet shumë më kompleks dhe të shumëfishjtë: sipas këtyre të dhënavë, lëvizja e individëve nga veriu i Alpeve kishte filluar tashmë gjatë shekullit paraprak (Verger 2015, 151). Gjatë njëzet viteve të fundit, një sërë studimesh janë përqendruar në identifikimin e objekteve kelte midis popullsive italike, duke i dhënë përparësi analizës së serive rajonale.<sup>3</sup> Megjithatë, vëmendja më e madhe i është kushtuar grupeve kelte që u vendosën në Itali midis shekujve IV dhe III para Krishtit. Për këtë arsy, përpara se të përcaktohej ndikimi i mbërritjes së Keltëve dhe integrimi i tyre në komunitetet lokale italike, ka qenë thelbësore të analizohej ky fenomen gjatë shekullit të mëparshëm, duke identifikuar të gjitha gjurmët arkeologjike që parashikojnë këto migrime dhe duke u përpjekur të zgjidhet një problem 100-vjeçar: si duhet të shpjegojmë gjetjet “kelte” në Itali gjatë shekullit para migrimeve?

Për të kuptuar përmasat e pranisë kelte në Italinë Veriore, ka qenë e domosdoshme të rishqyrtohej identiteti i tyre dhe të rivendoseshin artefaktet e gjetura në kontekstin e tyre kulturor, përmes një rishikimi të plotë të gërmimeve arkeologjike të mëhershme dhe materialit të lidhur me to.

Të ashtuquajturat “migrime kelte” kanë dhënë shumë botime, konferanca dhe ekspozita. Për disa dekada, përhapja e artefakteve nga traditat lokale përtej territoreve të tyre origjinale ka qenë një çështje me interes për protohistorinë. Historianët e kulturës e kanë shpjeguar praninë e artefakteve të ngjashme si rezultat i lëvizjeve të grupeve njerëzore. Analiza e shpërndarjes territoriale të këtyre gjetjeve i çoi arkeologët të pyesnin nëse zotëruesi i një objekti i përkiste një grupi kelt apo italik. Në fakt, mbetjet arkeologjike shpesh janë interpretuar në lidhje me një identifikim etnik.

Hulumtimi që kam kryer gjatë viteve të fundit na lejon të reflektojmë mbi natyrën e vërtetë të këtyre gjurmëve materiale, të cilat tregojnë marrëdhënie të hershme midis të dyja anëve të Alpeve dhe Detit Adriatik. Meqenëse çështjet e etnicitetit nuk kanë qenë kurrë larg arkeologjisë - dhe migrimet shpesh janë përdorur si një zgjidhje e thjeshtë për të shpjeguar një problem kompleks – kam vendosur të adoptoj një qasje të ndryshme. Gjatë viteve të fundit, jam përqendruar në Italinë Veriore. Intervali kronologjik i zgjedhur i paraprin migrimeve historike kelte dhe përfshin periudhën nga fundi i shekullit VI deri në fillim të shekullit IV para Krishtit. Korpusi përfshin artefakte të vonshme të Halshtatit dhe të hershme të Latenit, si dhe elemente të tjera të lidhura, të shpërndara në Italinë Qendrore dhe Veriore. Veçanërisht, duhet theksuar territorin e kulturës Golasecca, Etrurinë padane dhe venetët adriatikë.




Fig. 1. Italia Veriore: kultura Golasecca, venetët adriatikas dhe Etruria padane me vendet kryesore të përmendura në tekst.

Kjo metodë më mundëson të kryej krahasime në zonat kufitare: p.sh., Alpet, bregdeti Adriatik dhe Korsika. Kulturat e epokës së hekurit ishin të hapura ndaj ndikimeve të huaja. Këto njësi kulturore janë jashtëzakonisht të ndërlidhura dhe kontekstet funerare shfaqin një larmi elementesh: etruske, verialpine dhe mesdhetare. Epigrafia dhe onomastika konfirmojnë praninë e folësve keltë të integruar në komunitetet italike. Këta individë mund të kenë pasur emra të përgjithshëm që i përshkruanin si të huaj, si Eluveitie i Mantovës<sup>4</sup>, ose Keltie dhe Treute i Spinës<sup>5</sup>. Në raste të tjera, emrat e tyre sugjerojnë se ata kishin qenë pjesë e shoqërisë lokale për një kohë të gjatë dhe për disa gjenerata. Shembulli më i njohur është Tival-Bellen, i cili jetonte në Padova në fund të

shekullit VI para Krishtit (Gambacurta 2013, 32-33).

Së fundmi, kemi burimet arkeologjike, ku diversiteti mbizotëron edhe në qeramikë, metalurgji dhe ikonografi. Objektet metalike prej bronzi dhe hekuri, si fibulat dhe stolitë e veshjeve, janë më të rëndësishmet për qëllimet e këtij studimi. Objektet metalike, të lidhura me aktivitetet e përditshme dhe të gjetura jashtë zonës së tyre të origjinës, mund të konsiderohen si bartëse të identiteteve rajonale. Kjo mbështetet në parimin se këto objekte, të cilat janë më pak spektakolare sesa, për shembull, vazot e importuara, kanë vlerë të vogël tregtare jashtë zonës së tyre të prodhimit. Për këtë arsy, në literaturën arkeologjike ato janë shenja të preferuara antropologjike dhe kulturore për të identifikuar origjinën dhe statusin e zotëruar të tyre. Objektet e përfshira janë stolitë personale dhe armët sulmuese – dhe mbrojtëse. Ato gjenden pranë vendbanimeve, si dhe në kontekste funerare dhe votive të kulturave të përmendura më sipër. Këto objekte nuk janë vetëm mjete, por mund të shndërrohen në simbole që përfaqësojnë vlerën sociale.<sup>6</sup> Çdo material është studiuar individualisht dhe në lidhje me kontekstin e tij, për të identifikuar modelet e përsëritura të grumbullimeve me elemente “kelte”.

Në tezën time të doktoraturës, kam identifikuar tri fenomene të ndryshme të përsëritura në lidhje me shfaqjen e materialit “kelt” ose verialpin<sup>7</sup> në ansamblin e gjetjeve arkeologjike, në tri kushte studimi: 1) Artefakti është pjesë e një grupi prestigjioz objektesh. Ai tregon praninë e keltëve të integruar në elitën lokale ose është adoptuar nga popullata jokelte që i kanë dhënë atij një rol në shfaqjen e statusit përmes akumulimit të mallrave ekzotike. Shembulli më i dukshëm është një grup varresh në nekropolin Arnoaldi në Bolonja, në Etrurinë padane (Papi 2020b, 81-94). Një studim tipologjik dhe stilistik i objekteve në këto varre ka zbuluar bashkëjetesën e tri horizonteve kulturore: një grup të objekteve prej metali me traditë La Tène (shpata dhe kopsa rripi), objekte vendëse të jetës së përditshme (qeramikë lokale, gurë loje, aksesorë veshjeje) dhe disa vazo atike të një cilësie shumë të lartë, si kratere me volute.<sup>8</sup> Një situatë e ngjashme është gjetur në Spina. 2) Artefakti është adoptuar vetëm nga disa grupe të popullsisë. Ai shpesh ridisenjohet. Humbet funksionin dhe qëllimin e tij original. Bëhet pjesë e një konteksti tjetër gjinor ose trajtohet si një *ex-voto*.<sup>9</sup> Ky është rasti i kopsave të rripit: elemente funksionale të pezullimit të shpatës së kulturës së Latenit, të cilat, pavarësisht natyrës së tyre fillimi isht mashkullore, u adoptuan nga gratë më të pasura, në shoqërim me produkte të përzgjedhura, si objekte ari dhe argjendi dhe vazo të importuara (Papi 2021a, 78-95). 3) Artefakti shfaqet gradualisht në të gjitha varret e individëve të të dyja gjinive dhe zëvendëson objektet tradicionale vendëse. Disa nekropole të kulturës Golasecca-Bellinzona ndjekin këtë model. Nekropoli i Gudo është një shembull i mirë. Fillimi isht, elementet “kelte” u përhapën gradualisht në varret e individëve të gjinisë mashkullore: fibulat e hershme të kulturës Laten u bashkuan me llojet tradicionale (Certosa X-n dhe X-m) dhe i zëvendësuan ato gradualisht. Në fund, ato u bënë lloji i vetëm i përdorur gjatë periudhës Laten B1. Në kontrast, kontekstet femërore ruajtën fibula më të vjetra që datojnë deri në dy ose tri gjenerata më parë: përdorimi i tyre kishte ndaluar, por u përdorën përsëri dhe tregojnë gjurmë të mëdha riparimesh të vjetra (*ab antiquo*).

Disa faktorë mund të shpjegojnë praninë e produkteve ekzogjene në një vend arkeologjik. Dëshmitë arkeologjike, që përfshijnë tregtinë e mallrave ose lëvizjen e individëve, ndonjëherë mund të janë të vështira për t'u sasiuar. Migrimet lënë gjurmë

fizike që duhet vlerësuar në lidhje me një sërë faktorësh të tjerë, si për shembull pranimi i traditave të reja për një integrim më të shpejtë ose një dallim në vetëidentitetin midis sferës private dhe publike (Shih Burmeister 1996, 15-16).<sup>10</sup>

Migrimet janë një temë e përsëritur në literaturën e lashtë, ndonjëherë duke marrë përmasa mitike, siç u përmend më sipër. Një shembull tjetër është *Ver sacrum* (“pranvera e shenjtë”): një praktikë fetare e komuniteteve italike të lashta që rezultonte në një lëvizje të madhe njerëzore si proces pushtimi ose kolonizimi. Livy mbështetet në këtë sfond mitik për të shpjeguar “udhëtimin” e pushtuesve legjendarë keltë, Bellovesus dhe Segovesus, në një kohë që mendohet të ketë qenë bashkëkohore me Tarquinius Priscus. Të dërguar nga Ambigatus – mbreti i biturigëve – në kërkim të territoreve të reja, dy vëllezërit ishin përgjegjës për lëvizjet e para kelte.<sup>11</sup> Megjithëse praktika migratore e *Ver sacrum* pranohet zakonisht për samnitët dhe picentët, ajo nuk përputhet me praninë e artefakteve verialpine të gjatura në Itali përpara shekullit IV para Krishtit dhe për këtë arsy nuk e zgjidh problemin. Nuk ka asnjë dëshmi arkeologjike për pushtime ose migrime masive në Itali gjatë shekullit V para Krishtit. Nëse përjashtojmë idenë e një migrimi gradual, atëherë duhet të marrim në konsideratë mundësi të tjera.

Një hipotezë që nxjerr krye është lëvizshmëria individuale.<sup>12</sup> Gjatë dekadës së fundit, kërkimet mbi mobilitetin njerëzor kanë ndihmuar për të ndërtuar një tablo më dinamike të protohistorisë evropiane (Cicolani 2017). Suksesi i këtyre studimeve qëndron në përpjekjen për të kapërcyer “mbylljen” e vetë konceptit të “kulturës arkeologjike” dhe për të shpjeguar ndryshimet – tipologjike dhe teknike – të dukshme në burimet arkeologjike përmes qarkullimit të individëve dhe grupeve, të cilët kontribuan në kontaktin e drejtpërdrejtë midis popullatave të ndryshme (Bourdin 2012, 519-521). E bazuar te zejet, martesat ose qëllime tregtare, mobiliteti personal është sot në qendër të shpjegimeve për përhapjen e mallrave dhe njojurive në epokën e hekurit. Një shembull: ndikimi i arkeologjisë gjinore në studimet italiane ka rizbuluar rolin e grave në shoqëritë e lashta. Sipas modelit të konceptuar nga Kristian Kristiansen, lëvizshmëria e grave për shkak të martesave do të shpjegohej nga prania e elementeve të veshjeve larg mjedisit të tyre vendës (Kristiansen 1981, 254-255). Në këtë kuptim, do të ishte e mundur të shpjegohej shpërndarja e disa prej këtyre objekteve përmes praktikës së martesave egzogame. Strategjitetë martesore në protohistori janë theksuar edhe më shumë kohët e fundit: martesat ndërmjet popullsive të ndryshme, të përdorura për të krijuar aleanca politike, u dhanë arsyе autorëve Casini dhe Chaume (2012, 231-237) të shpjegonin përhapjen e objekteve personale të tipit Golasecca jashtë kufijve territorialë të kësaj kulture. Dëshmitë epigrafike nga Este dhe Padova gjithashtu e dëshmojnë këtë proces.

Martesat ndërmjet popullsive të ndryshme ndoshta lehtësuan kontaktin dhe integrimin kulturor. Por përhapja e objekteve përkon gjithashtu me qarkullimin e mallrave përmes tregtisë, dhuratave diplomatike apo aktivitetave kulturore dhe tregtare (Bourdin 2012, 557). E njëjta gjë vlen për vazot greke dhe enët etruske prej bronzi të gjatura në varret princërore të kulturave Hallshtat në veri të Alpeve. Këto mallra prestigjioze gjenden krah për krah me objekte të tjera më modeste dhe të përdorimit të përditshëm. Ky kombinim jo vetëm që na jep një ide më të mirë për shpërndarjen e këtyre produkteve “të zakonshme”, por gjithashtu, për shkak të natyrës së tyre, e bën më të lehtë kuptimin e përfshirjes së shtresave më të ulëta të popullsisë, si tregtarëve,

artizanëve dhe grave, në rrjedhat e shkëmbimit dhe kontakteve, përtej elitave që tradicionalisht konsiderohen si hisedarët kryesorë.

Një tjetër çështje është “efekti shoqëror” i lëvizjeve njerëzore, veçanërisht multikulturalizmi që ato prodhonin. Gjatë epokës së hekurit, Italia Veriore tregon një diversitet të madh kulturor dhe artefaktet arkeologjike të tipologjisë vernalpine janë pjesë e një konteksti tashmë të larmishëm. Në kapërcim të shekullit IV dhe III para Krishtit, popullsitetë vendëse italike nuk zhduken plotësisht. Në fakt, disa rajone nuk duket se janë prekur nga ardhja e keltëve: për S. Bourdin (2015, 553), “...ky ishte një fenomen që, larg të qenit një rast përzierjeje etnike, është e kundërtë e saj.”

Autori citon si shembull mbishkrimet etruske të gjetura në Adria dhe Spina, të cilat shoqërohen me një shpërndarje shumë të rrallë të artefakteve të kulturës Laten. Siç ka treguar puna ime e mëparshme (Papi 2021b, 301-307), gjetjet kelte nga portet etruske të deltës së Posë janë të rralla si në shekullin V, ashtu edhe pas shekullit IV para Krishtit. Për periudhën që na intereson, qarkullimi i artefakteve ka të bëjë kryesisht me transferime kulturore, por nëse popullsitetë “pritëse” e adoptojnë një artefakt, kuptimi i tij original nuk ruhet gjithmonë.

### **Çfarë shprehin artefaktet?**

Kam zgjedhur të analizojoj objektet apo artefaktet arkeologjike prej metali, pasi ky lloj objekti përfshin një numër të madh kategorish që i referohen fushave semantike shumë të ndryshme. Objekte të vogla personale, si fibulat, përdoren për të mbajtur bashkë rrobat. Ato janë pjesë e përdorimit të përditshëm dhe një element i zakonshëm në varre, por ndonjëherë fibulat nuk kanë vetëm funksion praktik: ato janë krijuar për të qenë vepra arti dhe për të shprehur pasurinë e të ndjerit. Në varietetet e tyre dallojmë diferenca rasonale dhe lidhje me çështjet e identitetit dhe gjinisë. Nga një perspektivë ekonomike, fibulat nuk kanë një vlerë të veçantë. Megjithatë, ato mund të përdoren si tregues apo indikatorë rajonalë, për të vëzhguar lëvizjet e individëve. Si objektet më të përdorura të kostumit antik, ato mund të konsiderohen si një lloj “fosil udhërrëfyes”. Prania e tyre në vendet arkeologjike përdoret për të datuar nivelet stratigrafike, pasi karakteristikat e tyre morfollogjike evoluojnë shumë shpejt. Duke qenë element funksional, është e arsyeshme të supozohet se përhapja e tyre pasqyron lëvizjen e njerëzve.

Ndonjëherë, identiteti i të ndjerit shprehet përmes posedit të objekteve të caktuara, si shpatat e tipit Laten. Një shpatë mund të zbulojë aktivitetin ushtarak të pronarit të saj, por mund të tregojë gjithashtu përdorimin e armëve kelte nga jokelte. Siç thekson Lejars (2020, 240): “...shpata është, së bashku me fibulën, burimi ynë kryesor i provave materiale për lidhjet e ngushta midis keltëve të Italisë dhe komuniteteve të Alpeve Veriore.” I njëjti parim vlen edhe për shekullin që i parapriu ardhjes së tyre.

Prania e materialit arkeologjik të periudhës së vonë të Halshtatit dhe asaj të hershme të Latenit nxjerr në pah lidhjen e veçantë midis Italisë Veriore dhe territoreve në veri të Alpeve. Interpretimi i tyre arkeologjik lejon këndvështrime të shumta. Shtrirja gjeografike e artefakteve jashtë zonës së tyre origjinale evoluon me kalimin e kohës, dhe përhapja hapësinore mund të varet nga një sërë faktorësh, duke përfshirë shkëmbimin tregtar, martesat egzogame, bashkëpunimin artizanal etj.

Është e qartë, megjithatë, se fibulat, armët dhe kopsat e rripit të periudhës se Halshtatit dhe Latenit, të gjetura në Itali, nuk mund të interpretohen sistematikisht si tregues të migrimeve. Ato përbëjnë tri grupe themelore artefakte për të matur dukshmërinë arkeologjike të grupeve të para kelte në Italinë Veriore, por pranimi i një artefakti në një komunitet tjetër përfshin fenomene shumë më komplekse.

Armët kanë pasur një vlerë identitare që në antikitet dhe pranimi i tyre në një shoqëri tjetër mund të ndodhë në nivele të ndryshme. Këto objekte mund të ruajnë funksionin e tyre origjinal ose të ripërpunohen nga komunitetet pritëse, si në rastin e kopsave të rripit të kulturës Laten (Stöllner 2014, 233). Studimet e mia të mëparshme kanë treguar se pranimi i këtyre kopsave ndryshon sipas zonës kulturore, duke u bërë një simbol statusi social në kulturat etrusko-padane dhe venete (Papi 2020a, 328-329; Papi 2020b, 11). Ky fenomen dëshmon për ndryshimin e ngarkesës simbolike: kulturat italike që i pranuan këto objekte i adoptuan si artefakte, por jo edhe kuptimin e tyre origjinal.

### Në një mënyrë kelte? Një stil lokal me ndikime kelte midis Italisë dhe Ballkanit

Megjithatë, ekziston edhe një faktor tjetër që shpesh lihet jashtë vëmendjes: prodhimi lokal i një sërë elementesh që tregojnë një ndikim të qartë kelt. Vathët e prodhuar në Veneto midis shekujve V dhe IV para Krishtit, janë një shembull i tillë.



Fig. 2. Padova, nekropoli Via Tiepolo, varri 32/1990-1991. Vathë argjendi (Gambacurta dhe Ruta Serafini 2014, fig. 7)

Vathët me skaje të ndërlikuara ose të përdredhura nuk janë artefakte tipike të Halshtatit të vonë ose të Latenit, por ata kanë ndikime të dallueshme verialpine. Ky prodhim lokal në stil kelt përfshin 28 vathë nga pesëmbëdhjetë kontekste të ndryshme, të gjitha në rajonin e Venetos. Shumica e tyre vijnë nga kontekste funerare (Este, Montebelluna, Gazzo Veronese). Tipologjia e tyre është si në vijim: vathët janë bërë prej bronzi, hekuri, argjendi ose ari. Në disa raste fundi i tyre përbëhet nga një formë komplekse me rruaza globulare, ndërsa të tjerë kanë një fund më të thjeshtë, të përdredhur në formë

“S”-je. Diametri varion nga 4.6 cm në 9 cm. Më të zakonshmit janë vathët me skaj të ndërlikuar, prej të cilëve janë identifikuar 18 ekzemplarë.




Fig. 3. Hartë e densitetit të vathëve në rajonin e Venetos: 1) Este, 2) Gazzo Veronese; 3) San Briccio në Lavagno, 4) Montebello Vicentino; 5) Montecchio Maggiore; 6) Padova; 7) Montebelluna.

Vathët i përkasin kategorisë më të vonë të korpusit tim, duke u datuar në periudhën Laten B. Forma e skajit të tyre mundëson dallimin e dy serive të ndryshme: Seria më e vjetër (Laten B1) përfshin ekzemplarë me skaje më të ndërlikuara dhe të përcaktuara mirë, si vathët nga Montebello Vicentino, varri Este-Casa Ricovero 222 dhe varri Via Tiepolo 32. Shembujt më të vonshëm (Laten B2) kanë skaje më të stilizuara.

Këta vathë janë shumë të ndryshëm nga tradita lokale, megjithëse shpërndarja e tyre mbetet pothuajse ekskluzivisht në Veneto. Forma e skajit është e ngjashme me “stilin plastik” kelt – megjithëse më e vonshme – e gjetur në veri të Alpeve, veçanërisht në zonën lindore dhe Bohemia, si unazat e kyçit nga Klettham (Bavari) dhe Plaňany (Bohemia), por këto janë vetëm krahasime të pjesshme. Mungesa e krahasimeve të drejtpërdrejta me zonën verialpine dhe shpërndarja e kufizuar i karakterizojnë këta vathë si produkte të artizanatit venet, por me një diferencim nga tradita lokale për shkak

të aspektit plastik të përfundimeve dhe përdorimit të metaleve të çmuara. Një tjetër krahasim i mundshëm për këtë lloj objekti, gjithnjë brenda kategorive të objekteve zbuluruese, mund të bëhet me rruazat prej pastës se qelqit me motive oculi (syri), të cilat mund të shërbjnë si një paralelizëm i mirë.



Fig. 4. Vathët: 1-4) Este dhe Montebello Vicentino. Rruazat: 5-6) Ceneda, nekropoli Ai Frati (Arnosti 1996, fig. 15); 7) Forcello, Mantova (De Marinis dhe Rapi 2007, fig. 136); 8) Bucy-le-Long (Desenne 2009, fig. 136). Unaza kyçi: 9) Klettham; 10) Plaňany (Moscati 1991, 268, 270).

Nga gjysma e dytë e shekullit V para Krishtit, ndonëse këto rruaza kanë qenë të pranishme prej disa shekujsh më parë, u përhapën, veçanërisht në Evropën Qendrore, duke arritur edhe territorë të ndryshme në distanca të largëta. Ato janë shfaqur në Gali, Itali, Ticionon, Sloveni dhe Bohemi. Duke u rikthyer te përhapja e vathëve në varret e venetëve adriatikas, vihet re një shoqërim i shpeshtë me bojkte të stilit/tipit të Latenit, të cilat i përkasin konteksteve me objekte prestigjioze: Varri Este-Casa Ricovero 226, ku vathët gjenden bashkë me fibula të stilit/tipit Laten dhe qeramikë atike; Varri Este-Casa Ricovero 126/1993, me fibula Latene; Varri Este-Casa Ricovero 20, me një kopsë rripi dhe unaza rripi (Papi 2021a, 84-85). Për kontekste me objekte më të pasura dhe gati aristokratike, shihni varrin Montebelluna 264 dhe varret Este-Casa Ricovero 23 dhe 36 (Fig. 5). Gjetjet kryesore janë të përqendruara në zonën e Estes dhe ky mbizotërim është interpretuar si rezultat i një prodhimi lokal në punishte të specializuara, të cilat

prodhonin zbukurime “ekzotike” për të përbushur kërkesat e një klientele të zgjedhur lokale.



Fig. 5. Este-Casa Ricovero 23, i quajtur varri i Nerka Trostiaia 1. Vendosja e përgjithshëme e objekteve funerare; 2. Urnë funerare antropomorfe me vathë ari me skaje të ndërlikuara dhe fibula ari të tipit Latene; 3. Krater atik i tipit “bell” (me trup në formë kambane) që i atribuohet piktorit të Filottranos (Gambacurta dhe Ruta Serafini 2019, 46-47).

Qendra e Montebello Vicentino shfaq gjithashtu një përqendrim të konsiderueshëm të këtyre vathëve: të dhënat nuk janë të mjaftueshme për të sugjeruar praninë e punishteve artizanale lokale, por ato na lejojnë të rikonstruktojmë një zonë shpërndarjeje që shtrihet në territoret përreth, me një hapje drejt verilindjes. Në një shkallë me të gjerë gjeografike, shpërndarja e vathëve sugjeron një shtrirje edhe në territor të tjera verilindore: një fragment është gjetur në vendbanimin Castelraimondo në Forgària (UD), brenda një ndërtesë nga fillimi i shekullit IV para Krishtit, ndërsa një ekzemplar i plotë, megjithëse vetëm pjesërisht i krahasueshëm, është gjetur në një vendruajtje në Castelselva, në Levico (TN).

Në anën tjetër të Adriatikut, në Ballkanin Verior, ka paralele të tjera: në Nezakcij (Istri), ku vathë argjendi me skaje të përdredhura janë gjetur në varrin I/3744. Edhe pse këto objekte nuk janë të shumta, ato tregojnë për një shpërndarje më të gjerë përgjatë boshtit Tagliamento, një rrugë e përdorur tashmë për tregtinë ndërmjet Alpeve dhe Adriatikut të Epërm.

Në Gadishullin Ballkanik, përhapja e elementeve të kulturës së Halshtatit prek kryesisht Istrinë dhe duket të jetë më shumë e lidhur me grupin lindor të Halshtatit sesa me atë perëndimor. Studimet mbi grupin perëndimor të Halshtatit janë shumë të

kufizuar, por gjithsesi mundësojnë disa konkluzione.

Mbërritja e keltëve në Itali, nga njëra anë, dhe themelimi i kolonive greke në Adriatikun qendror – basshkë me përhapjen e helenizmit – nga ana tjetër, shënuan fillimin e fazës së fundit VI të kulturës Histria gjatë shekullit IV para Krishtit (Gabrovec dhe Mihovilić 1987, 314-317). Kjo fazë përkon me fazën e pestë të kronologjisë istriane të propozuar nga J. Šašel në 1984.




Fig. 6. Lokalizimi i Nesactium dhe kulturat kryesore protohistorike në Ballkan.

Në gjysmën e dytë të shekullit V para Krishtit, në Nesactium, në lindje të Pulës, shfaqet një helmetë e tipit Negau me origjinë sllovene, e cila vazhdon të përdoret edhe gjatë shekullit IV para Krishtit, së bashku me një tip alpin të grüpuit “Sanzeno”, i pranishëm deri në shekullin I para Krishtit (Mihovilić 1996, 52-55). Së bashku me këtë tip të ri helmete, gjejmë gjithashtu: një majë shtize hekuri me teh të gjatë, një lloj i ri sëpate me “veshë”, një armë tipike e vonshme e kulturës se Halshtatit, karakteristikë për të gjithë rajonin e Alpeve juglindore. Dëshmi të tjera tregojnë për kontakte me botën keltike Halshtatit, ndonëse jo aq të përhapura sa në Italinë Veriore, siç janë situlat me motive figurative me dre, dhive alpine dhe zogj fluturues; fibula të vonshme Certosa të tipit X, XII dhe VII; një kopsë rripi nga varri Nesactium 1/3, i cili ka një paralel të ngushtë me varrin Este-Capodaglio 31, që përbën elemente të kulturës Latne nga rajoni i Venetos. Edhe më interesante është prania e vathëve të argjendit me skaje të

përdredhura, të cilët janë elemente tipike të stilit kelt, por që, siç kemi parë, janë të lidhur më shumë me kulturën e venetëve adriatikas (Mihovilić 2001, 263). I njëjtë model haset gjithashtu në Notranjska (Slloveni), me një përshtatje lokale, ku vathi përdoret si byzylyk (Gustin 1973, 479). Ndër artefaktet e njoitura deri më tanë në Istri, objektet kelte janë jashtëzakonisht të rralla. Kjo është arsyaja pse dëshmitë për kontaktet me ndikimin kelt të kulturës venete janë veçanërisht të rëndësishme.<sup>13</sup>

Në rajonin e Venetos, si qendrat kryesore në fusha, ashtu edhe vendbanimet periferike, tregojnë praninë e elementeve vernalpine (fibula dhe më vonë edhe vathë), të cilat u shfaqën në një fazë të hershme në kapercim të shekujve V dhe IV para Krishtit (Calzavara Capuis dhe Ruta Serafini 1987, 281; Papi 2021a, 84-87). Prania e tyre është jashtëzakonisht e rëndësishme në këtë zonë, siç do të shihet në paragrafin vijues. Që nga kjo fazë fillestare, bëhet e qartë një rrjet qarkullimi përgjatë luginave të Adige dhe Piave. Në fakt, dëshmi të kontakteve të hershme shfaqen në luginën e sipërme të Piaves dhe Cadore, duke sugjeruar një hapje ndaj zonave të para alpine. Këto zona kanë dhënë gjithashtu objekte të ngjashme, si fibula me koka rosash dhe këmbë në formë daullesh të dyfishta, të gjetura në Belluno (Caverzano) dhe Trento (Sanzeno, Mechel). Këta shembuj të tipologjisë së vonshme të Halshtatit lidhen me një seri të tërë fibulash me këmbë zoomorfe, të afërtë me fibulat tierkopffibeln të rajonit alpin lindor, shpërndarja e të cilave është kryesisht e përqendruar në zonën lindore të Alpeve dhe arrin deri në territoret sllovene përftej lumit Isonzo (Migliavacca 2012, 69-71).

Në traditën arkeologjike italiane, rajoni i Venetos është konsideruar gjithmonë si i mbyllur ndaj ndikimeve kulturore të jashtme, për shkak të numrit të vogël të mallrave të importuara të gjetura aty. Kjo perspektivë u përbys vetëm pas punës së Irene Favaretto (1976), e cila përpiloj për herë të parë një katalog të qeramikës atike të gjetur në vendet kryesore të Venetos. Që nga ajo kohë, shumë specialistë kanë studiuar artefaktet “ekzotike” në kontekstet funerare të Venetos. Në 50 vitet e fundit, prania e materialeve të importuara brenda kulturës së Venetos nuk shkakton më asnjë debat. Situata aktuale tregon një kulturë mjaft selektive dhe të rrënjosur në tradita, por që nuk i refuzon elementet e importuara, të cilat zakonisht janë të kufizuara në kontekste funerare të pasura. Rishikimi i të dhënave ka çuar në identifikimin e disa varreve që kombinojnë objekte nga kultura të ndryshme. Kështu, gjejmë urna funerare të tipit lokal, objekte personale të tipit lokal (rripa bronzi, fibula të tipit Certosa), objekte të tipit lokal, por tashmë në stil kelt (vathë me skaje të ndërlikuara), objekte të tipit të Halshtatit të vonë ose të Ltenit (fibula të tipit Marzabotto, fibula Latene me këmbë të pasme, kopsa rripi). Grupi i enëve të qeramikës tregon një larmi të ngjashme, me enë të traditës lokale venete (gotat prej balte gri), produkte të importuara (gotat etrusko-padane dhe vazo attike me figura të kuqe). Siç ka vërejtur tashmë O.H. Frey (1988, 37): “...është e qartë nga kjo se [...] kontaktet midis dy rajoneve nuk mund të kenë qenë episodike, por se ka pasur marrëdhënie afatgjata gjatë fazave të Hallstattit të vonë.”

Megjithatë, në vend që të tregojnë sistematikisht praninë fizike të një “të huaji” në vend, këto marrëdhënie janë gjithashtu të përputhshme me një sistem tregtie dhe shkëmbimi, të parashikuar tashmë nga Capuis (1994, 64) dhe Adam (1996, 42). Përhapja deri në Istri e konfirmon këtë hipotezë dhe nxit vazhdimin e kërkimeve në këtë drejtim. Në fakt, edhe pse përhapja e elementeve kelte përftej harkut alpin njihet nga komuniteti shkencor, ende mungon një studim i plotë që mbulon gjithë territorin.

Doktoratura ime ishte hapi i parë drejt një analize krahasuese të kulturave të përfshira.

Sic është përmendur më parë, kam identifikuar tri fenomene të ndryshme të përsëritura lidhur me shoqërimin e materialeve vernalpine/kelte me tërësinë e gjetjeve arkeologjike. Mendoj se do të ishte interesante të zgjerohej kjo perspektivë dhe të kuptohej nëse dhe si sektori ballkanik përfshihet në të njëjtat fenomene të vëzhgaura në Itali gjatë shekullit V para Krishtit. Tanipërtani, nuk ka studime të disponueshme mbi këtë çështje, prandaj një rishikim i plotë i të dhënave të disponueshme, sic është kryer për Italinë Veriore, do të ishte e mirëpritur. Kjo ese është menduar si një pikënisje për një analizë më të gjerë, e cila synon të mbulojë të gjithë Gadishullin Ballkanik dhe harkun sloven, ku tashmë janë identifikuar elemente të lidhura me kulturën e Halshtatit (këtë herë lindore).<sup>14</sup>

## Përfundimi

Hulumtimi i kryer për këtë artikull ka (ri)përcaktuar natyrën e marrëdhënieve midis grupeve të para kelte dhe Italisë së Veriut në shekullin e V para Krishtit. Ky studim u bazua kryesisht në një rishikim të dokumentacionit ekzistues dhe burimeve arkeologjike. Rishikimi i të dhënave ishte hapi themelor në identifikimin e korpusit dhe kontekstualizimin e secilit artefakt. Kam identifikuar 49 lokalitete që kanë prodhuar artefakte të tipit të Halshtatit të Vonë ose Latenit të Hershëm. Kështu është përpiluar një koleksion prej 370 objektesh. Këta tregues kanë bërë të mundur nxjerrjen në pah të disa dinamikave në kontaktet midis të dyja anëve të Alpeve dhe Detit Adriatik, por gjithashtu kanë ngritur disa pyetje.

Së pari, këto kontakte nuk kufizohen vetëm në shekullin V para Krishtit. Burimet epigrafike tregojnë për origjinën e tyre më të hershme, të konfirmuara nga shumë mbishkrime në shkrimin leponik – një gjuhë kelte alpine. Në fund të shekullit të VI para Krishtit, shpatat me dorezë në formë “antene” të stilit Halshtat shfaqen në varret më të pasura të komuniteteve Golasecca dhe Felsina (Bolonja). Këta shembuj të parë, ashtu si edhe ata që pasojnë, nuk lejojnë të bëhet një dallim midis pranisë fizike të individëve të huaj apo shprehjes së statusit të një elite vendase përmes armëve ekzotike. Origjina e individit luan një rol dytësor, pasi identiteti etnik dhe prejardhja janë subjekt i një interpretimi të ndërtuar rrëth diskursit modern, që ndryshon sipas gjykimit të arkeologut. Të dhënat arkeologjike janë thelbësore, por të pamjaftueshme për të zgjidhur këtë çështje.

Megjithatë, duke ndjekur një qasje arkeologjike, nevojitet një qartësim i mëtejshëm: në vend që të përdorim shprehjen “futja e grupeve të para kelte”, do të ishte më e përshtatshme të flitej për mënyrat e shoqërimit të artefakteve të para kelte. Shumica e vëzhgimeve të mia lidhen me qarkullimin e këtyre artefakteve, të cilat përfshijnë komunitete që ruajnë fort traditat e tyre materiale. Në të vërtetë, këto objekte duket se janë përdorur si manifestim i statusit shoqëror, më shumë sesa të jenë sjellë nga individë që lëviznin. Sipas të dhënave të mbledhura, nuk ka pasur lëvizje të grupeve të organizuara gjatë shekullit V para Krishtit. Vetëm në disa raste shumë specifike mund të pritet prania fizike e keltëve në këtë periudhë të hershme. Gjurmët materiale dhe mbishkrimet zbulojnë një prani relativisht diskrete. Onomastika tregon rrënje kelte,

ndërsa mbishkrimet janë gjithmonë të shkruara në alfabetin lokal. Është e arsyeshme të supozohet se, nëse ka pasur një prani fizike, akulturimi ka ndodhur përmes gjuhës.

Në rastin e objekteve ekzogjene nga një varr, hipoteza që sugjerohet më shpesh është lëvizja e individit. I ndjeri mund të ketë marrë me vete disa artefakte tipike të rajonit të tij të lindjes. Disa gjetje duket se pasqyrojnë kontakte të drejtpërdrejta, qoftë përmes lëvizjes së një individi (martesë jashtë komunitetit?) apo të një grupi të vogël njerëzish (mercenarë?). Kjo qasje nuk është e gabuar në vetvete, por nuk mund të ndahet nga një analizë më e gjerë që fokusohet në të gjithë ansamblin e gjetjeve. Në kontekstet që kam studiuar, shumica e artefakteve janë pjesë e kulturës materiale vendëse: zakonet funerare, qeramika dhe objektet personale janë të krahasueshme me ato të gjetura në vende të tjera fqinje. Nga ana tjetër, këto ansamble karakterizohen nga një orientim i fortë ndaj modeleve të huaja dhe akumulimit të objekteve prestigjioze. Ky përfaqësim shoqëror përfshin grupimin e varreve dhe, në disa raste, monumentalizimin e hapësirës funerare.

Shprehja “objekt prestigji” mund të jetë pak e fortë për komponentët e korpusit tonë. Vetëm disa artefakte tregojnë trajtim të veçantë: veshjet sipërfaqësore, riparimet ab antiquo dhe manipulimet janë raste të rralla. Megjithatë, ato shoqërohen me elemente ekzotike, të përfshira në ndërtimin e një “portreti shoqëror”. Mund të supozojmë se artefaktet e kulturës se Halshtatit dhe Latenit janë pjesë e këtij fenomeni. Konteksti funerar përfshin një shumëlojshmëri asemblazhesh: etruske, veriore-alpine dhe mesdhetare. Terreni është kështu i hapur ndaj ndikimeve të shumta.

Aspekti më i rëndësishëm është dinamika e shkëmbimeve. Përhapja e artefakteve veriore-alpine pasqyrohet nga prodhimi lokal i objekteve me karakter të fortë kelt. Ky fenomen, i dëshmuar që në shekullin V para Krishtit nga zhvillimi i fibulave të tipit “hibrid”, ilustrohet qartë nga prodhimi i vathëve me fund të ndërlikuar, shpesh të punuar nga metale fisnike. Kjo situatë sugjeron se lidhjet tregtare lejonin qarkullimin e modeleve dhe produkteve përtej Detit Adriatik e madje deri në Ballkan. Mund të ketë pasur një tregti tekstile, e shoqëruar me produkte dytësore si fibulat. Për më tepër, megjithëse tekstilet rrallë ruhen në gjermimet arkeologjike, përshtypjet e tyre në metal mbeten të përjetshme dhe mund të studiohen. Së fundmi, ekziston një numër i madh kopsash rripash të punuar me ornamente të hapura nga kontekste femërore, të cilat shpesh janë të lidhura hapësinorisht me njëra-tjetrën. Prania e tyre në territorët e Golasecca dhe Veneti dëshmon për një ngarkesë të re simbolike: kulturat pritëse përvetësojnë artefaktin, por jo domosdoshmërisht kuptimin e tij origjinal. Sipas stilit të dekorimit, disa pjesë mund të janë prodhuar në vend. Kjo do të shpjegonte shfaqjen e kopsave të zbuluar të rripit në gjysmën e parë të shekullit IV para Krishtit kur ekzemplarët transalpinë pushuan së përdoruri.

Duke zgjeruar kornizën kronologjike deri në fund të shekullit IV para Krishtit, dy vërejtje dalin në pah. E para ka të bëjë me mungesën e njohurive për rajonin Cisalpin në fillimet e vendosjes së supozuar kelte. Si gjithmonë, një argument ex silentio duhet trajtuar me kujdes. Megjithatë, gjurmët e para të lëvizjeve kelte do të duhej të ishin të pranishme që në çerekun e parë të shekullit IV. Në vendet që ofrojnë dokumentacion të pandërprerë, ato gjurmë nuk janë as të shumta dhe as të pashmangshme. Duke rishikuar burimet arkeologjike, një pyetje duket thelbësore: çfarë tregojnë artefaktet e invazionit kelt në Itali?

Nëse e largojmë vëmendjen nga burimet e shkruara dhe i qasemi kësaj ngjarjeje vetëm përmes prizmit të dëshmive arkeologjike, situata paraqitet shumë ndryshe nga ajo që tradicionalisht pritet. Mbetjet e hershme të kulturës se Latenit do të duhej të ishin mjaft të shumta, por mbi të gjitha të përhapura në mënyrë kapilare nëpër gjithë territorin. Në kontrast, analiza e materialit nga fillimi i shekullit IV tregon vetëm disa gjurmë. Kështu që, një pyetje tjetër del në sipërfaqe, ndoshta më drejtpërdrejt: a mund të flasim vërtet për invazion kelt?

Do të ishte e arsyeshme të pritej një përhapje e konsiderueshme e artefakteve të La Tène, që do të përputhej me një lëvizje të madhe të njerëzve. Duke ndjekur një trajktore veri-jug, ato gjurmë do të duhej të përhapeshin nga Alpet deri në Luginën e Posë. Nuk mohoj se migrime mund të kenë ndodhur. Megjithatë, besoj se përmasat dhe ndikimi i tyre duhet të vendosen në perspektivë. Dukshëm, okupimi kelt duket të ketë qenë mjaft i ndërprerë dhe i kufizuar. Për më tepër, është e vërtetë që disa vendbanime vendore të mëparshme u braktisën, por të tjera u themeluan në të njëjtën kohë. Vendbanime urbane dhe rurale vendase mbijetuan, dhe kulturat italo-kelte bashkëjetuan. Burimet e lashta ende kanë ndikim të madh në kuptimin tonë për keltët: shfaqja e një kulture elitare të përzier duhet ta ndryshojë këndvështrimin tradicional për një valë shkatërruese.

## FUNDNOTAT

**1** Për të cituar Pliniun e Vjetër: “[...] Quapropter haec vel bello quaesisse venia sit”, *Nat. Hist.*, XII., 5.

**2** Këto përfshijnë Betejën e Elleporusit (387-386 p.e.s.), Rrethimin e Rhegionit nga Sirakuza (388-387 para Krishtit), dhe plaçkitjen e Romës nga Brennusi sipas traditës analistike romake (390 para Krishtit).

**3** Do të përmendim punimet e P. Sankot për rajonin bohem (1996), S. Casini dhe B. Chaume për kulturën Golasecca (2014), V. Cicolani për kulturën Golasecca (2017), R. Roncador për rajonin Retik (2017), G. Gambacurta dhe A. Ruta Serafini për kulturën Este (2019).

**4** Mbishkrimi vjen nga një grafit i shkruar me karaktere etruske mbi një enë qeramike të gjetur në Mantova. Ky emër dëshmon për praninë e një personi që e identifikon veten si helvetik. Shih Vitali dhe Kaenel 2000, 118-119.

**5** Këto mbishkrime janë klasifikuar si kelte bazuar në interpretimin e G. Colonna-s dhe aludojnë për një identitet kelt të pranuar me vetëdije. Ky identifikim, i cili në shumicën e rasteve është i përbashkët, mbetet ende çështje debati. S. Bourdin (2012) preferon variantin *Kemtie* në vend të leximit tradicional *Keltie*, duke e lidhur atë me një emër gentilici tashmë të njobur në rajonin e Latiumit. Mbishkrimi *Treute* i Spina-Valle Pega, i cili ka qenë i pabotuar për një kohë të gjatë, është rishikuar së fundmi nga A. Gaucci, i cili propozon një lexim të ri që thekson dimensionin etrusk. Nga ana tjetër, i njëjti autor e konsideron një rast të onomastikës kelte në Adria, në mbishkrimin *mi uinias anteš [...]* nga një tas i datuar midis fundit të shekullit VI dhe fillimit të shekullit V para

Krishtit (Colonna 1993, 140). Përkundër Bourdin 2012, 582, 616 dhe Gaucci 2019, 417. Për Adria, shih Andrea Gaucci 2017, 289.

**6** Siç do të shpjegohet më poshtë, më duket e qartë se dëshmitë e kulturës Latene të gjetura larg vendit të saj origjinal nuk mund të interpretohen sistematikisht si tregues të përkatësisë ndaj një entiteti kulturor specifik.

**7** Preferoj përdorimin e termit “veriore-alpine” në vend të “kelte” për shkak të mungesës së implikimeve etnike.

**8** Roli i kraterit attik me volute në manifestimin e pushtetit dhe pasurisë është vënë në dukje gjërësish nga studimet e A. Tsingarida gjatë Kongresit *Le cratère à volutes. Destination d'un vase de prestige entre Grecs et non-Grecs* (Paris 2014) dhe S. Verger lidhur me nekropolin Trebenište në Maqedoni (2014).

**9** Ndër vendet kryesore të përfshira në këtë fenomen, përmend Melegnano (kultura Golasecca), Este-Casa Ricovero, Este-Villa Benvenuti, Este-Capodaglio, Gazzo Veronese, Lågole (Venetët Adriatikë).

**10** Shih Burmeister 1996, 15-16. Për të shpjeguar ndryshimin midis sferës publike dhe asaj private, autori jep një shembull nga historia bashkëkohore. Duke vëzhguar emigrantët e parë evropianë të vendosur në Shtetet e Bashkuara, ai vëren se ata u përshtatën fuqishëm me kulturën e re në sferën publike. Nga ana tjeter, traditat e origjinës së tyre ruheshin në sferën private, domethënë në kontekstin familjar, ku ato treguan rezistencë ndaj ndikimeve të jashtme: dokumentet fotografike tregojnë përdorimin e objekteve të përditshme tradicionale të Evropës.

**11** Sipas rrëfimit të Livot, ky migrim ndahet midis dy destinacioneve: Italia, e cila i është dhënë nga perënditë Bellovesusit dhe pylli Hercynian, i vendosur në skajin verior të tokës sipas këndvështrimit grek. Për një analizë të rrëfimit të Livot, shih Verger 2003, 333-369; Peyre 2007, 363-375; Bourdin 2017, 593-595; Gambacurta 2019, 65-69.

**12** Hulumtimi mbi lëvizjen e njerëzve është pjesë e një qasjeje ndërdisiplinore dhe tani është shkencërisht i konfirmuar përmes teknikave fizike. Përbërja izotopike e mbetjeve skeletore njerëzore, si kockat dhe dhëmbët, mund të japë informacione mbi aspekte të ndryshme të jetës së kaluar. Analiza e raporteve izotopike të strontiumit ( $^{87}\text{Sr}/^{86}\text{Sr}$ ) siguron informacion mbi lëvizshmërinë individuale. Raportet izotopike  $^{87}\text{Sr}/^{86}\text{Sr}$  të një mjedisit të caktuar përrithinen dhe fiksohen në pjesën minerale të kockave dhe dhëmbëve të njeriut dhe kafshëve. Shtresa e smaltit dentar, pasi formohet gjatë fëmijërisë, nuk ripërtërihet, duke ruajtur firmën izotopike të strontiumit që është biologjikisht i pranishëm në mjedisin ku subjekti ka lindur dhe ka jetuar vitet e para të jetës (Bentley 2006, 136-139). Kështu, duke krahasuar raportin izotopik  $^{87}\text{Sr}/^{86}\text{Sr}$  të dhëmbëve të një individi me atë të mjedisit përreth (vegjetacioni, toka, fauna, uji), është e mundur të përcaktohet nëse një individ ka lindur dhe ka jetuar fëmijërinë e hershme në të njëjtin vend ku është varrosur ose rikuperuar. Vlerat izotopike të strontiumit dhe oksigenit konsiderohen specifike për rajone gjeografike dhe shërbjejnë si tregues të

besueshëm kimikë të historisë së migrimit të popullatave të kaluara (lokale ose jo në vendin e gjetjes). Në veçanti, analiza izotopike e strontiumit është e dobishme për të analizuar shtrirjen dhe rrugët e migrimit (drejtimin dhe gamën) dhe për të studiuar lëvizshmërinë e popullatave të lashta njerëzore (Sehrawat dhe Kaur 2017, 249-251).

**13** Hulumtimet aktuale nuk kanë zbuluar praninë e elementeve të tilla në Gadishullin Ballkanik jugor. Studimet mbi praninë keltike gjatë shekullit të 5-të datojnë që nga vitet 1980 dhe një rishikim i dokumentacionit duhet të merret në konsideratë.

**14** Përmend “pionierët” e arkeologjisë keltike në pellgun e Karpatëve: Miklós Szabó (1940-2023) dhe Venceslas Kruta.

## BIBLIOGRAFIA

- Adam, Anne-Marie. 1996. *Le fibule di tipo celtico nel Trentino*. Trento: Servizio beni culturali.
- Arnosti, Giorgio. 1996. “L’età del Ferro nell’Antico Cenedese.” *Quaderni del Circolo Vittoriese di Ricerche Storiche* 2: 48–86.
- Bentley, Alexander. 2006. “Strontium isotopes from the earth to the archaeological skeleton: a review.” *Journal of Archaeological Method and Theory* 13 (3): 135–187. <https://doi.org/10.1007/s10816-006-9009-x>.
- Bourdin, Stéphane. 2012. *Les peuples de l’Italie préromaine : identités, territoires et relations interethniques en Italie centrale et septentrionale*. Rome: École Française de Rome.
- Bourdin, Stéphane. 2015. “L’Italie du Nord préromaine : multi-ethnicité, métissages ou transferts culturels ?” In *Du transfert culturel au métissage*, edited by Michel Molin, Silvia Capanema and Quentin Deluermoz, 549–564. Rennes: Presse universitaire de Rennes.
- Bourdin, Stéphane. 2017. “Forme di mobilità e dinamismi etnico-culturali nell’Italia centro-meridionale.” In *Ibridazione e integrazione in Magna Grecia. Forme, modelli, dinamiche*, edited by Arcangelo Alessio, Mario Lombardo and Aldo Siciliano, 103–122. Taranto: Istituto per la storia e l’archeologia della Magna Grecia.
- Burmeister, Stefan. 1996. “Migration und ihre archäologische Nachweisbarkeit.” *Archäologische Informationen* 19 (1-2): 13–21. <https://doi.org/10.11588/ai.1996.1&2.16917>
- Calzavara Capuis, Loredana and Ruta Serafini, Angela. 1987. “Per un aggiornamento della problematica del celtismo nel Veneto.” In *Celti ed Etruschi nell’Italia centro-settentrionale dal V secolo a.C. alla romanizzazione*, edited by Daniele Vitali, 281–307. Bologna: University Press.
- Capuis, Loredana. 1994. “Celtismo nel veneto: marginalità culturale e marginalità etnica.” In *Numismatica e archeologia del celtismo padano*, edited by Giovanni Gorini, 57–70. Aosta: Fondazione Andrea Pautasso.

- Casini, Stefania and Chaume, Bruno. 2012. "Indices de mobilité au Premier Âge du fer entre le Sud et le Nord des Alpes." In *Les Celtes et le Nord de l'Italie (Premier et Second Âges du fer)*, edited by Philippe Barral, 231–250. Revue archéologique de l'Est, supplément 36.
- Cicolani, Veronica. 2017. *Passeurs des Alpes. La culture de Golasecca : entre Méditerranée et Europe continentale à l'Âge du fer*. Paris: Hermann.
- Colonna, Giovanni. 1993. "La società spinetica e gli altri ethne." In *Spina: Storia di una città tra Greci ed Etruschi*, edited by Fede Berti, 131–143. Ferrara: Comitato Ferrara Arte.
- De Marinis, Raffaele C. 1991. "I Celti golasecciani." In *I Celti*, edited by Sabatino Moscati, 93–102. Venezia: Bompiani.
- De Marinis, Raffaele C., and Rapi, Marta. 2007. *L'abitato etrusco del Forcello di Bagnolo S. Vito (Mantova): le fasi arcaiche*. Firenze: Tipo-Lito Operaia.
- Desenne, Sophie. 2009. "Bucy-le-Long. Aisne. Une nécropole de La Tène ancienne (Ve-Ive siècle avant notre ère)." *Revue archéologique de Picardie* 26 (1): 271–334.
- Frey, Otto-Hermann. 1971. "Fibeln vom westhallstattischen Typus aus dem Gebiet südlich der Alpen." *Oblatio, Como*: 355–386.
- Frey, Otto-Hermann. 1987. "Sui ganci di cintura celtici e sulla prima fase di La Tène nell'Italia del nord." In *Celti ed Etruschi nell'Italia centro-settentrionale dal V secolo alla romanizzazione*, edited by Daniele Vitali, 9–22. Bologna: University Press.
- Frey, Otto-Hermann. 1988. "Les fibules hallstattiennes de la fin du VIe siècle en Italie du nord." In *Les princes celtes et la Méditerranée*, edited by Jean Pierre Mohen and Alain Duval, 33–43. École du Louvre.
- Gabrovec, Stane and Mihovilic, Kristina. 1987. "Istarska grupa, Praistorija jugoslavenskih zemalja." *Zeljezno doba* 5: 293–338.
- Gambacurta, Giovanna. 2013. "I Celti e il Veneto." *Études Celtiques* 39: 31–40. <https://doi.org/10.3406/ecelt.2013.2396>
- Gambacurta, Giovanna. 2019. "I Celti in Tito Livio tra Etruria e Veneto: dallo stupore al prodigo." *Preistoria Alpina* 49bis: 65–69.
- Gambacurta, Giovanna and Ruta Serafini, Angela. 2014. "Veneti e Celti tra V e III secolo a. C." In *Les Celtes et le Nord de l'Italie (Premier et Second Âges du fer)*, edited by Philippe Barral, 259–272. Revue archéologique de l'Est, supplément 36.
- Gaucci, Andrea. 2017. "Adria." *Studi Etruschi. Rivista di epigrafia etrusca* LXXIX: 286–295.
- Gaucci, Andrea. 2019. "Spina." *Studi Etruschi. Rivista di epigrafia etrusca* LXXXI: 366–371.
- Gustin, Mitja. 1973. "Kronologija notranjske skupine." *Arheoloski Vestnik* 24: 461–506.
- Kristiansen, Kristian. 1981. "Economic model for Bronze Age in Scandinavia: towards an integrated approach." In *Economic Archaeology: towards an integration of ecological and social approaches*, edited by Alison Sheridan and Geoff Bailey, 239–303. Oxford: International Series.

- Kruta, Venceslas and Moucha, Václav. 2018. "Une fibule ornithomorphe du début du Ve siècle avant J.-C. au musée de Slaný (Bohême)." *Archeologický ústav* 70: 67–90.
- Lejars, Thierry. 2015. "Les armes laténienes en contexte cultuel. Au-delà de la rouille et des apparences." *Bibracte* 26: 29–40.
- Lejars, Thierry. 2020. "Pluralité ethnique et culturelle à travers l'exemple de l'épée celtique dans l'Italie préromaine des IVe et IIIe s. av. J.-C." *Adriás* 6: 231–260.
- Marzatico, Franco. 2014. "Lungo le vie dell'Est: scambi culturali fra Reti, Veneti e popolazioni dell'area sudalpina orientale." In *Transalpinare*, edited by Géraldine Alberti, Clément Feliu and Gilles Pierrelvin, 403–422. Bordeaux: Mémoires.
- Migliavacca, Mara. 2012. "Paesaggi pastorali nella montagna veneta: archeologia ed etnoarcheologia." In *La lana nella Cisalpina romana. Economia e società. Studi in onore di Stefania Pesavento Mattioli*, edited by Maria Stella Busana, 69–79. Padova: University Press.
- Mihovilic, Kristina. 1996. "Nezakcij, Nalaz grobnice 1981. The Discovery of a Grave Vault in 1981", *Monografije i katalozi* 6, Pula: Arheološki muzej Istre.
- Mihovilić, Kristina. 2001. "L'Istria tra Celti e Roma." In *I Celti nell'Alto Adriatico, Antichità altoadriatiche*, edited by Giuseppe Cuscito, 261–275. Aquileia, 2001: Antichità Altoadriatiche.
- Moscati, Sabatino. 1991. *Les Celtes*. Venezia: Bompiani.
- Papi, Linda. 2020a. "Modalità di inserimento dei primi gruppi celtici in Italia settentrionale. Due esempi a confronto." *Adriás* 6: 321–334.
- Papi, Linda. 2020b. "Les Étrusques de Felsina entre Athènes et La Tène." *Mélanges de l'École Française de Rome. Antiquité* 132 (1): 81–94.
- Papi, Linda. 2021a. "Transferts matériels et immatériels au Ve siècle av. J.-C. : les agrafes de ceinture laténienes en Italie du Nord-Ouest." In *Mobility and Exchange across Borders*, edited by Veronica Cicolani, 78–95. Oxford: Archaeopress.
- Papi, Linda. 2021b. "Modalités d'insertion des premiers groupes celtes en Italie du Nord, au V<sup>e</sup> siècle av. J.C." PhD diss., Université Paris Sciences et Lettres. Unpublished.
- Peyre, Christian. 2007. "Les migrations gauloises vers l'Italie d'après le témoignage de Tite Live", In *La Gaule dans son contexte européen aux IVe et IIIe siècles avant notre ère. Actes du XXVIIe colloque international de l'AFEAF*, edited by Christine Mennessier-Jouannet, Anne-Marie Adam, Pierre-Yves Milcent, 363–375. Lattes: Afeaf.
- Sehrawat, Jagmahender S. and Kaur, Jaspreet. 2017. "Role of stable isotope analyses in reconstructing past life-histories and the provenancing human skeletal remains: a review." *Anthropological Review* (2017), 243–258.
- Stöllner, Thomas. 2014. "Mobility and cultural change of the Early Celts: La Tène openwork belt-hooks north and south of the Alps." In *Les Celtes et le Nord de l'Italie (Premier et Second Âges du fer)*, edited by Philippe Barral, 211–229. Lattes: Afeaf.
- Verger, Stéphane. 2003. "Le bouclier de Diviciac. À propos de Liv. V, 34." In *L'immagine tra mondo celtico e mondo etrusco-italico*, edited by Daniele Vitali, 333–369. Bologna: Gedit.

- Verger, Stéphane. 2015. “L’âge du Fer ancien : l’Europe moyenne avant les Celtes historiques (800-400).” In *L’Europe celtique à l’Âge du Fer (VIIIe-Ier siècles)*, edited by Olivier Buchsenschutz, 75–176. Paris: Nouvelle Clio.
- Vitali, Daniele, and Kaenel, Gilbert. 2000. “Un Helvète chez les Étrusques vers 300 av. J.-C.” *Archäologie Schweiz* 23: 115–122.

### **Rreth autores**

Linda Papi është studiuese dhe arkeologe e specializuar në fushën e keltëve dhe marrëdhënieve etrusko-italiane. Ajo ka marrë titullin Doktore e Shkencave në Arkeologji nga Universiteti i Parisit “*Sciences et Lettres*”, pasi përfundoi studimet e saj të nivelit Master në Protohistori në Universitetin e Milanos. Ajo ka kryer kërkime shkencore në Francë, Itali, Zvicër, Greqi dhe Shqipëri. Që nga viti 2022, ka udhëhequr misionin arkeologjik në Ulpianë, Kosovë, nën drejtimin e C. Goddard, A. Hajdari dhe M. Berisha. Puna e saj fokusohet në eksplorimin e marrëdhënieve komplekse midis shoqërive protohistorike në Evropë dhe Mesdhe gjatë Epokës së Hekurit.

Përkthimi: Arsim Canolli

Redaktimi i përkthimit: Arben Hajdari

Lektura: Adelinë Selmani